

























<p>Neni 1</p> 	<p>Përkufizimi i fëmijës</p> <p>Fëmija është personi nën moshën 18 vjeç.</p>
<p>Neni 2</p> 	<p>Mosdiskriminimi</p> <p>Asnjë fëmijë nuk duhet të diskriminohet për shkak të ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinionit, vendit të origjinës, varfërisë ose pasurisë, paaftësisë ose përkatësisë në një pakicë etnike.</p>
<p>Neni 3</p> 	<p>Mirëqenia e fëmijës është e rëndësishme</p> <p>Në të gjitha ligjet dhe vendimet juridike, mirëqenia e fëmijës është parësore.</p>
<p>Neni 4</p> 	<p>Zbatimi i të drejtave</p> <p>Çdo shtet duhet të sigurojë, në maksimumin e mundësive të tij, zbatimin e të drejtave të fëmijës.</p>





<p>Neni 5</p> 	<p>Respekti për të drejtat prindërore</p> <p>Çdo shtet është përgjegjës për të siguruar që detyrimet, të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve të përmbushen në mënyrë të tillë që fëmijët të jenë të lirëtë ushtrojnë të drejtat e tyre. (Qeveritë duhet të respektojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve, anëtarëve të fëmijës ose kujdestarëve ligjorë duke informuar dhe këshilluar fëmijët për të drejtat e tyre).</p>
<p>Neni 6</p> 	<p>Mbijetesa dhe zhvillimi i fëmijës</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë për të jetuar dhe mbijetuar. Shteti duhet të garantojë zhvillimin fëmijës dhe të rinjve.</p>
<p>Neni 7</p> 	<p>Emri dhe nënshtetësia</p> <p>Çdo fëmijë, që nga lindja, ka të drejtën për një emër, për një nënshtetësi dhe për përkujdesje nga prindërit e tij.</p>
<p>Neni 8</p> 	<p>Mbrojtja e identitetit</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë të mbajë ose të rrimarë emrin e tij, nënshtetësinë dhe marrëdhëniet familjare.</p>

<p>Neni 9</p> 	<p>Ndarja e prindërve</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtën për të jetuar me prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo është për mbrojtjen nga prindërit e tyre. Nëse një fëmijë duhet të ndahet nga njëri ose nga të dy prindërit, ata kanë të drejtën të dëgjoen. Nëse një fëmijë duhet të ndahet nga njëri ose nga të dy prindërit, ata kanë të drejtë të dinë vendndodhjen e tyre.</p>
<p>Neni 10</p> 	<p>Ribashkimi i familjes</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë të lerë çdo shtet dhe të udhëtojë për në vendin e tij, për t'u bashkuar me familjen e tij.</p>
<p>Neni 11</p> 	<p>Mbrojtja nga rrëmbimi</p> <p>Çdo shtet duhet të luftojë kundër rrëmbimit të fëmijës dhe largimit të tij në një vend tjetër dhe moskthimin e fëmijës nga një prind ose nga një person tjetër.</p>
<p>Neni 12</p> 	<p>E drejta e opinionit vetjak</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë të dëgjoen dhe të shprehë mendimin e tij për të gjitha çështjet që lidhen me jetën e tij. Në mënyrë të veçantë, kjo ka vlerë ligjore ose në procedurat administrative. Sa më i rritur të jetë fëmija, aq më shumë duhet të dëgjoen mendimi i tij.</p>

<p>Neni 13</p> 	<p>Liria e shprehjes</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtën të shprehë lirisht opinionin e tij dhe të marrë e të përhapë informacion përmes medias. Çdo fëmijë ka edhe përgjegjësinë për të shprehur mendimin e tij, duke respektuar edhe të drejtat e të tjerëve.</p>
<p>Neni 14</p> 	<p>Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë të ushtrojë lirisht fenë e tij dhe të ushtrojë lirinë e mendimit dhe ndërgjegjes. Shteti duhet të respektojë të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve gjatë zbatimit të këtyre të drejtave.</p>
<p>Neni 15</p> 	<p>E drejta për grumbullime publike paqësore</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë për t'u bashkuar me fëmijë të tjerë, për të hyrë ose për të krijuar shoqata ose bashkime, për sa kohë në këtë proces nuk shkelin të drejtat e të tjerëve.</p>
<p>Neni 16</p> 	<p>Mbrojtja e jetës private</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë për të mos pasur ndërhyrje në jetën private, të familjes, të banesës ose të korrespondencës. Përveç kësaj, çdo fëmijë ka të drejtë që askush të mos dëmtojë figurën e tij.</p>

<p>Neni 17</p> 	<p>E drejta për t'i siguruar informacionin e duhur</p> <p>Çdo shtet duhet të sigurojë që çdo fëmijë të ketë mundësi reale për informacione përmes formave të ndryshme të medias dhe që ata të kenë mundësi të fitojnë njohuri që janë të rëndësishme për mirëqenien e tyre. Shteti ka detyrimin të mbrojë fëmijët nga informacionet e dëmshme.</p>
<p>Neni 18</p> 	<p>Përgjegjësia e prindërve</p> <p>Prindërit ose kujdestarët e fëmijëve janë përgjegjës për rritjen e fëmijës. Shteti ka përgjegjësinë t'i mbështesë ata në këtë, për shembull, të mundësojë kujdesin për fëmijët në rastet kur prindërit duhet të punojnë.</p>
<p>Neni 19</p> 	<p>Të rinjtë pa familje</p> <p>Çdo fëmijë që nuk jeton me familjen e tij, ka të drejtë për mbrojtje dhe mbështetje të veçantë. Ai ka të drejtë për një familje birësuese ose një institucion të përshatshëm që mban parasysh prejardhjen fetare, kulturore ose gjuhësore.</p>
<p>Neni 20</p> 	<p>Mbrojtja nga abuzimet</p> <p>Shteti është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës nga abuzimet e prindërve ose të njerëzve të tjerë. Ata kanë të drejtën të kenë një familje birësuese ose kujdes në institucione e duhura që marrin parasysh edhe prejardhjen fetare, kulturore e gjuhësore.</p>

 <p>Neni 21</p>	<p>Birësimi</p> <p>Një fëmijë mund të birësohet, nëse birësimi autorizohet, pranohet dhe aprovet nga vendi dhe nëse i shërben mirëqenies së fëmijës.</p>
 <p>Neni 22</p>	<p>Fëmijët refugjatë</p> <p>Çdo fëmijë, i cili është i detyruar të largohet nga vendi i tij, që është refugjat dhe kërkon azil, ka të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti.</p>
 <p>Neni 23</p>	<p>Fëmijët me aftësi të kufizuar</p> <p>Çdo fëmijë me aftësi të kufizuar ka të drejtën për kujdes dhe arsim të veçantë. Ai duhet të ndihmohet për të qenë i pavarur dhe për të marrë pjesë aktive në komunitetin të tij.</p>
 <p>Neni 24</p>	<p>Shërbimet shëndetësore dhe mjekësore</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë për kujdesin më të mirë të mundshëm mjekësor. Shteti ka detyrimin të luftojë vdekshmërinë foshnjore, të sigurojë mundësitë mjekësore për të rinjtë, të luftojë ushqimin e pamjaftueshëm dhe sëmundjet, të garantojë kujdes mjekësor për gratë shtatzëna dhe nënat e reja, të garantojë edukimin shëndetësor, të zhvillojë parandalimin në sektorin e shëndetit publik dhe të zhdukë zakonet që janë në dëm të fëmijëve.</p>

 <p>Neni 25</p>	<p>Rishikimi i trajtimit ose kujdesit</p> <p>Çdo fëmijë që ka qenë pranuar në një institucion për mbrojtjen, kujdesin ose trajtimin e tij ka të drejtë të kërkojë kontrollin dhe rishikimin e pranimit.</p>
 <p>Neni 26</p>	<p>Sigurimi shoqëror</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtën për siguri shoqërore, të tillë si sigurimet shoqërore. Shteti garanton pagesat për fëmijën, më varësi të situatës financiare të familjes ose të kujdestarit.</p>
 <p>Neni 27</p>	<p>Standardi i jetesës</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë për një standard jetese në përputhje me zhvillimin e tij fizik, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Prindërit ose kujdestarët janë përgjegjës kryesorë për të siguruar një gjë të tillë. Shteti ka detyrimin t'i mbështesë ata.</p>
 <p>Neni 28</p>	<p>Arsimi</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë të për arsimim dhe shkollim. Shteti ka detyrimin të bëjë arsimin bazë falas dhe detyruar dhe arsimin e mesëm të mundur për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Shteti ka detyrimin të sigurojë që fëmijët dhe të rinjtë të trajtohen si duhet në shkollë dhe të drejtat e tyre njerëzore të mos shkelen.</p>



Neni 29

Qëllimet arsimore

Arsimimi shkollor duhet të zhvillojë personalitetin dhe talentin e çdo fëmije, të përgatisë çdo fëmijë për jetën e rritur dhe të nxisë fëmijët për të respektuar të drejtat e njeriut dhe të drejtat e tyre, si dhe kulturën dhe vlerat e të tjerëve.



Neni 30

Fëmijët e pakicave

Çdo fëmijë që i përket një pakice ka të drejtën të mësojë për kulturën, fenë dhe jetën e tij artistike dhe t'i ushtrojë ato.



Neni 31

Pushimi, loja dhe koha e lirë

Çdo fëmijë ka të drejtë për pushim dhe kohë të lirë, në të cilën mund të luajë dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.



Neni 32

Puna e fëmijëve

Çdo fëmijë ka të drejtë për mbrojtje nga çdo formë e shfrytëzimit dhe pune, që mund të dëmtojë arsimimin dhe zhvillimin e tij. Shteti ka detyrimin të përcaktojë një moshë minimale të fëmijës për t'u lejuar të punojë dhe një numër orësh në ditë dhe kushte pune.



Neni 33

Mbrojtja nga drogat narkotike

Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga prodhimi dhe tregtimi i drogave të paligjshme.



Neni 34

Mbrojtja nga shfrytëzimi seksual

Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual dhe nga prostitucioni dhe pornografia.



Neni 35

Mbrojtja nga shitja dhe trafikimi





Shteti duhet të ndërmarrë të gjitha masat në juridiksionin e tij, për të garantuar që fëmijët dhe të rinjtë të mos shiten dhe trafikohen.



Neni 36

Mbrojtja nga të gjitha format e tjera të shfrytëzimit

Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e tjera të shfrytëzimit (p.sh. të lypurit).

<p>Neni 37</p> 	<p>Tortura dhe burgimi</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga tortura, trajtimi ose ndëshkimi mizor, arrestimi i paligjshëm ose nga çdo formë tjetër e shkeljes së lirisë personale. Shteti ka detyrimin të ndalojë dënimin me vdekje dhe burgimin e përjetshëm për të rinjtë. Nëse një fëmijë burgoset, ai ka të drejtën për trajtim njerëzor dhe me respekt. Nëse një fëmijë ose i ri arrestohet, ai duhet të mbahet i izoluar nga të rriturit, t'i mundësohet kontakti me familjarët dhe të ketë të drejtë për mbrojtje ligjore.</p>
<p>Neni 38</p> 	<p>Lufta dhe konfliktet e armatosura</p> <p>Fëmijët dhe të rinjtë nën moshën 15 vjeç kanë të drejtë të mos përfshihen në luftë dhe në konflikte të armatosura. Shteti ka detyrimin të sigurojë mbrojtje të veçantë për fëmijët që janë të prekur nga lufta.</p>
<p>Neni 39</p> 	<p>Rehabilitimi dhe integrimi</p> <p>Çdo fëmijë, që është viktimë e konfliktit të armatosur, torturës, shpërfilljes dhe shfrytëzimit, ka të drejtë për kujdesin e duhur për riaftësimin e shëndetit të tij mendor dhe fizik dhe për integrimin e tij në një komunitet.</p>
<p>Neni 40</p> 	<p>Drejtësia për rininë</p> <p>Çdo fëmijë i akuzuar për një krim ka të drejtën të trajtohet me dinjitet në gjykatë. Ai është i pafajshëm, deri sa fajësia e tij të jetë provuar në gjykatë. Çdo fëmijë ka të drejtën për një gjyq të drejtë, një interpretues (nëse është e nevojshme), për mbrojtjen e jetës private dhe për apelim të vendimit të gjykatës. Shteti ka detyrimin të vendosë një moshë minimale, nën të cilën fëmijët nuk mbajnë përgjegjësi penale. Shteti ka edhe detyrimin të ofrojë alternativa për ndëshkimin e fëmijëve dhe të rinjve, përveç burgosjes.</p>